



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 7, datë 31.01.2024

**PËR
MIRATIMIN E EMËRIMIT TË ADMINISTRATORIT
TË SHOQËRISË SË SIGURIMIT
“INSIG JETË” SH.A.**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 22, e ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, ligjit nr. 52/2014, “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit” dhe të rregullores nr. 137, datë 21.12.2015 “Mbi procedurën, afatet dhe dokumentacionin e nevojshëm/shtesë për miratimin e emërimit dhe riemërimit të anëtarit të Këshillit të Administrimit/ Këshillit Mbikëqyrës, administratorit/anëtarit të Bordit të Drejtorëve të shoqërisë së sigurimit”, e ndryshuar, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

- 1. Miratimin e emërimit të z. Endrit Abazi, në funksionin e administratorit të shoqërisë së sigurimit “Insig Jetë” sh.a., për një afat 2 vjeçar.**
- 2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit, për njoftimin në zbatim të këtij vendimi.**

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR
Olsi ÇOKU**

**NËNDREJTOR EKZEKUTIV
Mimoza KAÇI**